

Dr. Dorian Koçi

**RECENSË PËR LIBRIN E Prof. Ass. Dr. BERNARD
ZOTAJT “EPOPEJA E FITIMTARËVE”**

Lufta e Vlorës pa dyshim ishte një sfidë e gjithanshme politiko-ushtarake dhe atdhetare. Parë në pamje të zhvillimit të veprimeve luftarake, ishte një epike e madhe, e hapur dhe e vërtetë, e natyrës ushtarake. Sfidë ndaj arrogancës, këmbënguljes dhe kokëfortësisë së pushtuesit, për ta mbajtur Vlorën me forcën ushtarake të ndarë padrejtësisht nga pjesa tjetër e Shqipërisë së pavarur të vitit 1912.

Kjo luftë, e cila klasifikohet si një kryengritje popullore, në këndvështrim atdhetar, ndonëse u zhvillua në Vlorë dhe në zonat përreth, për nga ndjeshmëria dhe solidariteti atdhetar, u përhap shumë shpejt në të gjithë vendin. Çështja e Vlorës u shndërrua në një çështje kombëtare të të gjithë shqiptarëve, e materializuar edhe me vullnetarët që arritën nga të gjitha trevat e tjera të vendit. Kjo luftë dhe operacioni i saj luftarak, në thelb, ishin sfidë në përballje me tregues të luftimit tradicional shqiptar dhe me ata klasikë të operacioneve ushtarake. Kjo sfidë,



Bernard Zotaj

**Epopeja
e fitimtarëve**

5 qershor 1920-3 shtator 1920

EDITIMET M.H.B

gjendej pothuajse kudo, në përmasat e pjesëmarrjes, në kohëzgjatjen dhe shtrirjen e veprimeve luftarake, sikundër gjithashtu në natyrën dhe format e organizimit të kryengritjes, mobilizimit e përdorimit luftarak të forcave pjesëmarrëse në të, siç ishin të pranishëm dhe ndërtimi në funksionimin e drejtimit, nga fillimi deri në përmbylljen e objektivave të luftës.

Zgjidhja u gjend dhe në çështje të tilla përcaktuese të një operacioni si, në ekuilibrimin e mirëmenduar të raporteve të forcave me armikun përherë superior, në përqëndrimin dhe shpërndarjen e forcave kryengritëse vullnetare, gjatë dhe sipas drejtimeve të veprimeve e etapave luftarake të tij, në zbatimin e taktikës tradicionale të gërshetuar suksesshëm me atë frontale bashkëkohore, përdorimin e formave taktike rezultative në shpërthimin dhe kapjen e garnizoneve e të rajoneve të fortifikuar por të shkëputura të pushtuesve, si dhe në shumë aspekte të tjera të rëndësishme të kësaj luftime.

Lufta e Vlorës u organizua dhe u zhvillua si një operacion luftarak, në kuadrin e një kryengritjeje popullore, natyrisht e mbështetur fuqimisht nga populli dhe Qeveria shqiptare e Tiranës. Në këtë luftë u gjetën dhe gërshetuan harmonishëm, me vizion dhe sukses elemente të traditës, të trashëgimisë luftarake të krahinës, si dhe shqiptare në përgjithësi, me disa elementë të artit ushtarak të kultivuar të kohës. Përballë forcave dhe masave mbrojtëse të armikut, u vendosën për një përballje luftarake për jetë a vdekje forcat kryengritëse vlonjate, me vetëm 4.000 luftëtarë. Në pikëpamjen numerike formale, në prag të fillimit të fazës së parë, raporti real i forcave paraqitej me shifrat 14.000:4.000 ose 3.5:1 në dobi të pushtuesit.

Përsa i përket raporteve në armatime dhe teknikë luftarake epërsia ishte absolute për ta. Ndaj nisur nga pamja sasiore e për shkak të kësaj epërsie të theksuar, reagimi i Komandantit të Forcave Ushtarakë të Pushtimit në Shqipëri, gjeneral Piaçentinit, pasi mori ultimatumin e Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare, ishte tejet mospërfillës, arrogant. Sipas studiuesit B. Kanilia, gjenerali i ishte përgjigjur të dërguarit shqiptar Mehmet Selim Mallkeqit: “T’u

thoni brigantëve shqiptarë, se përgjigjen e letrës do ta japin topat e Kotës, Gjormit, Llogarait, Drashovicës, Tepelenës”.

Por, koha dhe fusha e luftës vërtetoi se përgjigja i’u kthye në bumerang gjeneralit! Veprimet luftarake, të shpejta dhe të befasishme të luftëtarëve kryengritës, e që mbështetej kryesisht te teknika luftarake të disponueshme, bënë që të heshtnin topat në Vlorë, Kaninë e Bestrovë dhe në garnizonet përreth saj. Në rrjedhën e luftës, raporti i forcave, armatimeve dhe municioneve të vullnetarëve shqiptarë erdhi në rritje për shkak të luftëtarëve që mbërritën nga krahinat e tjera të vendit, si dhe armëve e mjeteve luftarake të kapura armikut. Ndërsa në fazën e parë të luftës, Komiteti i “Mbrojtjes Kombëtare” kishte në gatishmëri dhe përdorim vetëm 4.000 luftëtarë, në fazën e dytë ky numër u rrit në më pak se 6.000 luftëtarë.

Gjithsesi, raporti i forcave vetëm u zbut asnjëherë nuk shkoi përtej përpjestimit 2:1. Dhe kjo në dobi të forcave ushtarake italiane që përbënin palën mbrojtëse. Kryengritësit u përpoqën dhe shpesh i’a dolën mbanë që ta kompensnin këtë diferencë me gjendjen e lartë moralo-psikologjike dhe nivelin e motivimit, me shpirtin sulmues, veprimet e shpejta dhe të fshehta, shfrytëzimin e natës dhe të terrenit të njohur, si dhe të manovrës së lartë etj. Kështu, ata ia dolën mbanë të detyronin kundërshtarin të tërhiqej nga Vlora përfundimisht. Vlora, kryeqyteti i parë i Shqipërisë dhe rrethinat e saj t’i bashkoheshin Shqipërisë amë.

E parë në një vështrim që shkon përtej euforisë, frymës së miteve dhe legjendave, ajo luftë solli vërtet disa të veçanta në zbatimin e treguesve të artit ushtarak të kohës. Tërheqin vëmendjen sidomos taktikat e përdorura me sukses prej luftëtarëve vlonjatë për shpërthimin dhe kapjen e garnizoneve të fortifikuara, të ngritura prej armikut në vijat e mbrojtjes, si në Kotë, Gjorm, Drashovicë, Matohasanaj, Llogora, Himarë, Tepelenë dhe në Qafën e Koçut, Termopilen e Vlorës.

Kryengritësit, megjithëse me forca dhe sidomos me armatime dhe mjete luftarake shumë më të pakta dhe të vjetëruara, ia dolën që t’i kapnin ato dhe efektivat e tyre, duke e vënë nën kërcënim

serioz qëndresën e pushtuesve brenda Vlorës dhe në rrethinat e saj. Taktika e përdorur kundër këtyre garnizoneve, me afrimin në mënyrë të fshehtë dhe natën, duke i rrethuar ato veç e veç dhe duke krijuar raporte forcash me epërsi minimale për sulmuesit, si 1.7:1 në Kotë, e cila pas një sulmi të fuqishëm ra në duart e sulmuesve shqiptarë, qe mjaft racionale dhe rezultative. Kështu u morën shumica e këtyre garnizoneve, përveç atij të Tepelenës, i cili u mbajt i bllokuar në një rrethim të plotë dyjavorë, derisa i gjithë efektiviteti i tij, oficerë dhe ushtarë, u dorëzua pa kushte.

Ky lloj luftimi dhe taktikat e përdorura për kapjen e tyre ishin një përvojë e re, e zbatuar me shumë sukses prej forcave kryengritëse vlonjate. E tillë ajo shfaqet dhe në fondin e artit ushtarak shqiptar, në tërësi. Në ditët e zhvillimit të Luftës së Vlorës, përveç disa drejtuesve kryesorë ushtarakë shumë të njohur, si Komandanti i Përgjithshëm i Forcave Luftarake që organizoi Komiteti i Mbrojtja Kombëtare, së pari major Ahmet Lepenica dhe, pas tij, ish-togeri i marinës luftarake, Qazim Koculi, Komisari i Policisë së Luftës, oficeri Shero Emini, Qeveria e Tiranës lejoi të merrnin pjesë edhe një grup oficerësh të karrierës. Këta oficerë, e në mes tyre major Mustafa Maksuti, kapiten Aziz Çami, Ismail Haki Kuçi, kapiten Tosun Selenica, toger Xhevdet Çelo e ndonjë tjetër, një pjesë e të cilëve ishin të njohur, ose më pas u bënë shumë të njohur në historinë ushtarake shqiptare, me ndihmën dhe me këshillat e drejtpërdrejta në drejtimin e veprimet luftarake dhanë ndihmesë të çmuar.